



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 2

Tiranë – E hënë, 16 janar 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 11.1.2017	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2017.....	7
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 11.1.2017	Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017 në njësitë e qeverisjes qendrore	8
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 11.1.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”..	13



VENDIM
Nr. 6, datë 11.1.2017

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË
MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2017, sipas lidhjes

Lidhja nr.1

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2017

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES
Janar	6	MF	Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSHP.
Janar	11	KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP.
Janar	18	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2018 - 2020.
Janar	27	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2018 – 2020.
Shkurt	17	MF	Paraqet në KM tavanet e përgatitjes së PBA 2018-2020 dhe limitet e angazhimeve të reja.
Shkurt	22	KM	Shqyrton dhe miraton tavanet e përgatitjes së PBA 2018-2020.
Shkurt	28	MF	Dërgon udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe udhëzimin për përgatitjen e buxhetit vendor në njësitë e qeverisjes vendore.
Mars	10	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal , si dhe Tavanet e përgatitjes së PBA 2018-2020.
Mars - prill	1 Mars - 28 Prill	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore.
Maj	1	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore.
Maj	2 - 19	MF, MIE dhe DPZHFNH	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore.
Maj - qershor	22 Maj - 2 Qershor	MF, MIE dhe DPZHFNH	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Qershor	5	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Qershor	7	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Qershor	12-22	MF	Përgatit dokumentin e PBA 2018-2020, tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2018-2020 dhe limitet e angazhimeve të reja.
Qershor	23	MF	Paraqet dokumentin e PBA 2018-2020, tavanet e reja të shpenzimeve dhe limitet e angazhimeve të reja, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	28	KM	Miraton dokumentin e PBA 2018-2020 dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2018-2020.
Korrik	3	MF	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2018-2020.
Korrik	7	MF	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Korrik - gusht	10 Korrik - 31 Gusht	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore.
Shtator	1	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore.
Shtator	2-15	MF, MIE dhe DPZHFNH	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore.
Shtator	16 - 29	MF, MIE dhe DPZHFNH	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Shtator	29	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Tetor	4	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Tetor	5-12	MF	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2018, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2018-2020 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.

nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integritimit Evropian, Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Tetor	15	KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2018, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2018-2020.
Tetor	19	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2018-2020, të miratuar nga KM.
Tetor	20	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2018.

VENDIM
Nr. 7, datë 11.1.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOSSHME PËR VITIN 2017 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 2 225 punonjës, sipas lidhjeve nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Për punonjësit e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Drejtorisë së Dëmshtëpërlimit të ish-të Përndjekurve Politikë dhe për praktikantët e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, të paraqitur në lidhjen nr.2, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përfshirë, pagesa për mjekët e kontraktuar të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i referohet vendimit përkatës të pagave për sistemin shëndetësor dhe pagesave për punonjësit e kontraktuar për Qendrën e Transferimit të Teknologjisë, Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve dhe Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për shkak të veçorisë së punës, përlogaritit sipas volumit të punës së kryer dhe paguhet sipas preventivit përkatës.

4. Përfshirë, punonjësit, të cilët merren me anketime të ndryshme të Institutit të Statistikave

dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, punonjësit që përfshihen në procesin zgjedhor, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, instruktorët e qendrave të Formimit Profesional si dhe mësuesit në dispozicion, në arsimin parauniversitar dhe arsimin profesional, nuk përfshihen në këtë vendim. Miratimi i numrit të këtyre punonjësve, afatet kohore dhe të tjera specifitime për kontraktimin me kohë të pjesshme të tyre bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të institucionit qendror përgjegjës dhe Ministrisë së Financave.

5. Mbulimi i efekteve financiare për punonjësit e kontraktuar bëhet nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2017, të njëjtit të qeverisjes qendrore. Për punonjësit e kontraktuar të Shtëpisë së Pushimit Durrës (të MPB), Shtëpisë së Pushimit të SHISH-it dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit. Për punonjësit e kontraktuar për ALUIZNI-n dhe qendrat e Formimit Profesional, përballohen pjesërisht nga të ardhurat dhe pjesërisht nga fondet buxhetore, të miratuara për vitin 2017. Për punonjësit që përfshihen në procesin zgjedhor të qeverisjes qendrore, efektet financiare përballohen nga fondi i miratuar për zgjedhje, për vitin 2017, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

6. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet, sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.2, të pikës 1, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

7. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij. Përfshirë, për pozicionet e kontraktuara për një periudhë njëvjeçare apo që janë në vijimësi nga viti i kaluar, efektet financiare fillojnë në datën 1 janar 2017 dhe pagesa e muajit dhjetor kryhet në fund të këtij muaji, me fondet e miratuara për vitin 2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja nr.1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
02	Kuvendi	10			
	Sektori i Botimeve Parlamentare	3	Specialist redaktimi	6 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun	2	Specialist audio-video	6 orë/ditë	vjetore
	Sektori i Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar	1	Punonjës protokollit	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Shërbimi Mirëmbajtjes	2	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi i Financës dhe Buxhetit	2	Inventarizues	6 orë/ditë	janar-mars, prill-gusht
03	Kryeministria	45			
	Aparati i Kryeministrit	34	Operator	6 orë / ditë	vjetore
	Aparati i Kryeministrit	11	Specialistë	6 orë / ditë	vjetore
04	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	32			
	Aparati	2	Punonjës pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	Aparati	1	Nëpunës roje	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati	5	Arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	ATRAKO	1	Punonjës pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	2	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	2	Punonjës arkiv-protokollit	6 orë/ditë	vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	1	Punonjës teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	1	Nëpunësinformacioni	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme Patentave, Markave	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme Patentave, Markave	1	Operatore	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (qendër)	2	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (qendrat rajonale)	3	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	4	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
05	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	125			
	Aparati	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati	1	Nëpunës roje	6 orë/ditë	vjetore
	QITB Vlorë	14	Punëtor fushe / mirëmbajtës		vjetor -sipas preventivit
	QITB Vlorë	4	Roje baza eksperimentale		vjetor -sipas preventivit
	QITB Lushnjë	14	Punëtor fushe		vjetor -sipas preventivit
	QITB Lushnjë	4	Punëtor		vetëm periudha pik
	QITB Korçë	8	Punonjës blegtorie		vjetor -sipas preventivit
	QITB Korçë	6	Roje objekti		vjetor -sipas preventivit
	QITB Korçë	9	Punëtor fushe		vjetor -sipas preventivit
	QITB Korçë	5	Teknik i mesëm		vjetor -sipas preventivit
	QITB Korçë	4	Punëtor		vetëm periudha pik
	QITB Shkodër	6	Roje baza eksperimentale (nëpunës informacioni)		vjetor -sipas preventivit
	QITB Shkodër	6	Punëtor fushe		vjetor -sipas preventivit
	QITB Shkodër	3	Punëtor		vetëm periudha pik
	QITB Fushë-Krujë	5	Punëtor fushe		vjetor -sipas preventivit
	QITB Fushë-Krujë	6	Roje baza eksperimentale (nëpunës informacioni)		vjetor -sipas preventivit
	QITB Fushë-Krujë	10	Teknik i mesëm		vjetor -sipas preventivit
	QITB Fushë-Krujë	2	Punëtor		vetëm periudha pik
	Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve	1	Punëtor mirëmbajtjeje		vjetor -sipas preventivit
	Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve	5	Teknik i mesëm		vjetor -sipas preventivit
	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve	2	Teknik i mesëm		vjetor -sipas preventivit
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	4	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	1	Drejtes motobarke	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	4	Punëtorë mirëmbajtës	6 orë/ditë	vjetore
06	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	13			
	Aparati	5	Specialist protokollit/arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	Instituti i Transportit	1	Punëtor pastrimi	4 orë / ditë	vjetore
	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor	1	Punëtor pastrimi	3 orë / ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve	1	Punëtor pastrimi	4 orë / ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve	1	Punonjës arkivi	6 orë / ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	1	Specialist kapitanerie	8 orë / ditë	qershor-shtator
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	1	Sanitar	6 orë / ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	1	Roje	6 orë / ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	1	Arkivist	6 orë/ditë	vjetore
10	Ministria e Financave	614			
	Aparati i Ministrisë	6	Specialist	8 orë/ditë	6- muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme/CFU)	2	Punonjës protokollit/arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Pagesave dhe Dëmtshpërblimeve	5	Specialist	8 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme)	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme/CFU)	3	Sanitare	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme)	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme)	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
	Degët e Thesarit në rrethe	7	Sanitar	3 orë/ditë	vjetore



	Agjencia Administrimit të Pasurive të Sekuestruara	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Dega e Thesarit Tiranë	3	Nëpunës informacioni/roje	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	5	Specialist	8 orë/ditë	6 - mujore
	Dega e Thesarit Skrapar	3	Specialist	5 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme të Doganave	23	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Laboratori Doganor	4	Sanitare	4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Procedurave	1	Nëpunës informacioni	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Elbasan	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Durrës	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Durrës	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Morinë	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Morinë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Kakavijë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Kakavijë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Kakavijë	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Bllatë Peshkopi	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Berat	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tri Urat Përmet	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Shkodër	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Shkodër	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Shkodër	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Lezhë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tiranë	2	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Rinas	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Vlorë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Vlorë	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Kapshitiçë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Korçë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Korçë	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Fier	2	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Sarandë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Sarandë	1	Shofer	4 orë/ditë	vjetore
	Aparati Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	Punonjës protokoll/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
	Aparati Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	500	Punonjës mirëmbajtjeje	8 orë/ditë	6-muaj
	Drejtoria Rajonale Tatimore	16	Punonjës protokoll/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria Rajonale Tatime.Dibër	1	Operator	4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria Rajonale Tatime.Durrës	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	44			
	Drejtoritë dhe zyrat rajonale arsimore	38	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Provimëve	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Inspektorati Shtetëror i Arsimit	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Publike Akreditimit Arsimit të Lartë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Agjencia e Shërbimeve të Sportit	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë së Arsimit	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
12	Ministria e Kulturës	43			
	Aparati	1	Lulishtar	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati	2	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	vjetore
	Biblioteka Kombëtare	3	Ndihmës-bibliotekar	4 orë/ditë	vjetore
	Galeria Kombëtare e Arteve	1	Vëzhgues/ciceron vizitorë PAK	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra Kulturore per Femije	1	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra Kulturore per Femije	1	Punëtor Dekorimi dhe skene	4 orë/ditë	vjetore
	Cirku Kombëtar	1	Teknik i mesëm (trobacepës)	4 orë/ditë	vjetore
	Cirku Kombëtar	1	Teknik i mesëm (marangoz)	4 orë/ditë	vjetore
	Cirku Kombëtar	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Cirku Kombëtar	1	Veteriner	4 orë/ditë	Mars-Dhjetor
	Cirku Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Mars-Dhjetor
	Muzeu Historik Kombëtar	2	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	vjetore
	Muzeu Historik Kombëtar	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Muzeu Historik Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Prill-Tetor
	ZAK Butrint	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	Maj - Tetor
	ZAK Butrint	3	Punëtor mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	Maj - Tetor
	ZAK Butrint	1	Biletashitës	6 orë/ditë	Maj - Tetor
	ZAK Parku Arkeologjik Apoloni	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	Maj - Tetor
	ZAK Parku Arkeologjik Apoloni	1	Punonjës pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	ZAK Parku Arkeologjik Bylis	1	Punëtor mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Mars - Tetor
	Muzeu i Artit Mesjetar Korçë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Muzeu i Artit Mesjetar Korçë	1	Punëtor mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	AQSHF	1	Specialist IT	6 orë/ditë	Vjetore
	AQSHF	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	QRV Artit	5	Restaurator	4 orë/ditë	Mars-Dhjetor
	Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Vjetore
	Instituti I Monumenteve të Kulturës	0	Shofer	4 orë/ditë	Vjetore
	Instituti I Monumenteve të Kulturës	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Prill-Shtator



	Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlore	1	Ciceron	4 orë/ditë	Qershor-Shtator
1	Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlore	1	Roje	4 orë/ditë	Maj - Tetor
13	Ministria e Shëndetësisë	23			
	Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë	4	Operator	6 orë/ ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë	2	Specialist	8 orë/ ditë	6-mujor
	Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë	1	Sanitar	6 orë/ ditë	Vjetore
	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	12	Operator	6 orë/ ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Cilësisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore	1	Operator	6 orë/ ditë	Vjetore
	Qendra e Edukimit në Vazhdim	1	Operator	6 orë/ ditë	Vjetore
lichja 1,1	Spitali Psikiatrik Elbasan	2	Kaldajist	8 orë/ditë	janar-mars;nëntor-dhjetor
14	Ministria e Drejtësisë	16			
	Ministria e Drejtësisë	12	Operatorë	8 orë/ditë	tremujore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Punëtor mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Operator	6 orë/ditë	vjetore
15	Ministria e Punëve të Jashtme	13			
	Aparati i Ministrisë	4	Preparatorë	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	3	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Postier	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Lulishtar	6orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Elektracist	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Punonjës ngarkim-shkarkimi	6orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
16	Ministria e Punëve të Brendshme	118			
	Shtëpia e Pushimit Durrës	6	Kuzhinier	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Ndihmës -kuzhinier	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	30	Kamerier	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	18	Punëtor restoranti	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Teknik	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	6	Receptionist	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	12	Punëtor Gjelbërimi	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	10	Punëtor Kuzhine	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	25	Punëtor Hoteli	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Elektracist	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
	Shtëpia e Pushimit Durrës	3	Lavanderi	8 orë/ditë	01.6.2017-10.09.2017
17	Ministria e Mbrojtjes	1			
	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	28			
	SHISH (shtëpitë e pushimit)	8	Kuzhinier	8 orë/ditë	qershor-shtator
	SHISH (shtëpitë e pushimit)	4	Banaker	8 orë/ditë	qershor-shtator
	SHISH(shtëpitë e pushimit)	13	Sanitar	8 orë/ditë	qershor-shtator
	SHISH(shtëpitë e pushimit)	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	SHISH(shtëpitë e pushimit)	2	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	10			
	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	1	Specialistë	8 orë /ditë	6- muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	1	Specialistë	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	8	Administratorë dokumentesh	6 orë/ditë	vjetore
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	38			
	Aparati i Ministrisë	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Shërbimit Kombëtar për Rininë	3	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	2	Kujdestar	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra Polivalente e Përkujdesit Social Poliçan	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Foshnjës Tiranë	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Fëmijëve Parashkollor Shkodër	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Durrës	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra kombëtare e Trajimit të Viktimave të Dhunës në Familje,	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e SH.S.SH	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e SH.S.SH	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Fier	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Fier	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore



	<i>Shtëpia e Foshnjës Durrës</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Korçë</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Shkodër</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Vlorë</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Sarandë</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Shkodër</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Korçë</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Vlorë</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Berat</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
28	Prokuroria e Përgjithshme	14			
	<i>Prokuroritëe rreth/apelit</i>	14	Sanitar	4 orë / ditë	vjetore
29	Zyra Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	37			
	<i>Gjykatat e rretheve /apeli gjyqësore, /Gjykata Administrative</i>	10	Sanitar	4 orë / ditë	Vjetore
	<i>Gjykatat e rretheve /apeli gjyqësore, /Gjykata Administrative</i>	6	Nëpunës gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykatat e Apelit Tiranë</i>	3	Sekretare gjyqësore	8 orë / ditë	6 muaj
	<i>Gjykatat e Apelit Tiranë</i>	1	Nëpunës gjyqësor	8 orë / ditë	6 muaj
	<i>Gjykatat e rretheve /apeli gjyqësore, /Gjykata Administrative</i>	10	Sekretare gjyqësore	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykatat e rretheve /apeli gjyqësore, /Gjykata Administrative</i>	2	Punëtor mirëmbajtjeje	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykatat e rretheve /apeli gjyqësore, /Gjykata Administrative</i>	5	Arkivist	4 orë / ditë	vjetore
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	5			
	<i>Agjencia Telegrafike Shqiptare</i>	2	Specialist- gazetar	6 orë / ditë	vjetore
	<i>Agjencia Telegrafike Shqiptare</i>	2	Specialist- përkthyes	6 orë / ditë	vjetore
	<i>Agjencia Telegrafike Shqiptare</i>	1	Fotograf	6 orë / ditë	vjetore
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1			
	<i>Qendra Kombëtare e Kinematografisë</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
66	Avokati i Popullit	7			
	<i>Avokati i Popullit</i>	7	Specialist	4 orë / ditë	vjetore
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	1			
	<i>Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil</i>	1	Nëpunës informacioni	6 orë / ditë	vjetore
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	2			
	<i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</i>	2	Sanitar	6 orë / ditë	vjetore
77	Autoriteti i Konkurrencës	2			
	<i>Autoriteti i Konkurrencës</i>	1	Specialist arkivist	6 orë / ditë	vjetore
	<i>Autoriteti i Konkurrencës</i>	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
87	Institucione te tjera qeveritare	9			
	<i>Inspektorati Qendror</i>	1	Sanitar	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Inspektorati Qendror</i>	1	Mirëmbajtës	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Inspektorati Qendror</i>	1	Punonjës arkiv- protokoli	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	1	Punonjës arkivi	6 orë / ditë	vjetore
	<i>Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale</i>	2	Teknikë të mesëm	8 orë /ditë	6- muaj
	<i>Këshilli Kombëtar i Ujit</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	<i>Komisioni i Prokurimit Publik</i>	1	Punonjës arkiv- protokoli	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Komisioni i Prokurimit Publik</i>	1	Teknikë të mesëm	6 orë/ditë	vjetore
88	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile	1			
	<i>Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile</i>	1	Specialist	8 orë/ditë	6- muaj
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	6			
	<i>Komisioneri</i>	1	Sanitar	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Komisioneri</i>	1	Teknik i mesëm	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Komisioneri</i>	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Komisioneri</i>	1	Arkivist	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Komisioneri</i>	2	Operatorë	6 orë/ ditë	vjetore
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	39			
	<i>Repartit Inspektim Shpëtim Miniera</i>	6	Teknik emergjence/shpëtimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Repartit Inspektim Shpëtim Miniera</i>	2	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati I MEI</i>	2	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati I MEI</i>	2	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati I MEI</i>	2	Specialist	8 orë/ditë	vjetore
	<i>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial</i>	2	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial</i>	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shërbimi Gjeologjik Shqiptar</i>	12	Roje objekti	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shërbimi Gjeologjik Shqiptar</i>	10	Teknikë gjeologë	6 orë/ditë	vjetore
94	Ministria e Zhvillimit Urban	728			
	<i>Drejtoritë Rajonale ALUIZNI</i>	600	Specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoritë Rajonale ALUIZNI</i>	14	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoritë Rajonale ALUIZNI</i>	100	Teknikë të mesëm	8 orë/ditë	vjetore
	<i>Arkivi Qendror Teknik</i>	1	Punonjës Arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Arkivi Qendror Teknik</i>	2	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit</i>	6	Specialistë	8 orë/ditë	6- muaj
	<i>Aparati i MZHU</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i MZHU</i>	1	Specialist arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i MZHU</i>	2	Specialistë	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i MZHU</i>	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	2,025			



Lidhja nr.2 "Mbi punësimin e 200 praktikantëve në institucionet buxhetore

Kodi	Emri i institucionit	Numri i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
3	Kryeministria	22	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
	INSTAT	7	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	9	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	9	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
10	Ministria e Financave	17	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	8	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
12	Ministria e Kulturës	6	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
13	Ministria e Shëndetësisë	12	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
14	Ministria e Drejtësisë	10	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
15	Ministria e Punëve të Jashtme	10	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
16	Ministria e Punëve të Brendshme	5	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
17	Ministria e Mbrojtjes	5	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	30	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
26	Ministria e Mjedisit	8	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
	Ministër Shteti për Marrëdhënie me Parlamentin	2	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
78	Ministria e Integritimit European	5	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
93	Ministria e Energjetikës dhe Industrisë	25	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor
94	Ministria e Zhvillimit Urban	10	Specialist IV-b	8 orë/ ditë	janar-nëntor

VENDIM

Nr. 8, datë 11.1.2017

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.953, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR.92/2014, 'PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHQIPËRISË', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 55, pika 2, 56, pika 38, e 159, të ligjit nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas nenit 5 shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese

1. Në zbatim të pikës 2, të nenit 55, të ligjit, personat e tatueshëm mund të ushtrojnë të drejtën të zgjedhin të aplikojnë dhe të paguajnë TVSH-në për furnizimin e ndërtesës ose pjesëve të një

ndërtese, duke e trajtuar furnizimin jo si të përjashtuar, por si furnizim të tatueshëm me shkallën standarde të TVSH-së prej 20%.

2. Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që furnizojnë apartamente, ndërtesa apo ambiente për banim ose kur blerësi është një individ.

Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite, me "apartamente, ndërtesa ose pjesë të saj apo ambiente për banim" kuptohen ato objekte të cilat furnizohen për qëllime banimi dhe blerësi është një person i tatueshëm, individ.

E drejta e zgjedhjes ushtrohet për ndërtesat ose pjesë të ndërtesës, të cilat furnizohen (shiten) për qëllim përdorimi për veprimtarinë ekonomike të blerësit, subjekt i regjistruar, ose për qëllime rishitjeje prej tij, por jo për banim.

3. Kur personi i tatueshëm ushtron të drejtën e zgjedhjes sipas pikës 1, të këtij neni, ai duhet të aplikojë zgjedhjen për çdo rast, përveç nëse blerësi është një person juridik i patatueshëm ose një person i tatueshëm që kryen veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Në këtë rast, është kusht që në kontratën e furnizimit të ndërtesës të shkruhet e shprehur qartë zgjedhja e dëshiruar nga furnizuesi dhe pranimi i saj nga blerësi.

4. Në rastin kur e drejta e zgjedhjes ushtrohet që në fazën e ndërtimit të një ndërtese, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim, ushtrimi paraprak i së drejtës së zgjedhjes detyron furnizuesin e ndërtesës që në deklaratën për



zgjedhjen të përcaktojë, të identifikojë qartë ndërtesën (ambientet) /ndërtesat me destinacion përdorimi ose shitjeje për qëllime biznesi dhe ndërtesat për t'u përdorur për qëllime banimi.

5. Në rastin kur blerësi, një person juridik i patatueshëm ose i përjashtuar nuk e pranon zgjedhjen, atëherë e drejta e zgjedhjes për të aplikuar TVSH-në e humb fuqinë e saj dhe nuk mund të ushtrohet për ambientet përkatëse.

6. Në rastin kur autoriteti tatimor konstaton një situatë abuzimi ose mashtrimi, atëherë kjo përbën arsye për të rrëzuar zgjedhjen e aplikuar prej furnizuesit të ndërtesës.

7. Personat e tatueshëm, që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes për furnizimin e ndërtesës sipas këtij neni, duhet ta ushtrojnë atë në përputhje me këto kritere, si dhe modalitetet e rregullat e përcaktuara në nenet 6/1 dhe 7/1, të këtij vendimi.

8. Për qëllime të zbatimit të së drejtës së zgjedhjes sipas neneve 5/1, 6/1 e 7/1, kjo e drejtë ushtrohet për furnizimin e ndërtesës ose pjesë të ndërtesës, momenti i furnizimit të së cilës është pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

2. Pas nenit 6 shtohet neni 6/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Modalitetet dhe rregullat e ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës

1. Personi i tatueshëm ushtron këtë të drejtë duke paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore një deklaratë me shkrim, ku deklaron se furnizimi i ndërtesës do të trajtohet si furnizim i tatueshëm me TVSH 20%. Kjo deklaratë, e cila formalizon qëllimin e personit të tatueshëm për të aplikuar regjimin normal të TVSH-së për furnizimin e ndërtesës, përmban të dhënat për çdo ndërtesë/ambient, të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm blerës (emri, NIPT-i adresa etj.) si dhe të dhënat mbi lejen e ndërtimit dhe qëllimin e përdorimit të ndërtesës.

2. Për qëllime të së drejtës së zgjedhjes është kriter domosdoshmëria e një kontrate noteriale midis furnizuesit dhe blerësit, në të cilën duhet të jetë shprehur qartë se palët bien dakord se furnizimin e ndërtesës do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Furnizuesi duhet të disponojë në çdo rast kontratën përkatëse të furnizimit, të cilën e vë në dispozicion të

autoriteteve tatimore, kur i kërkohet. Mungesa e kontratës së furnizimit nuk i jep të drejtën e trajtimit të shitjes së ndërtesës si furnizim i tatueshëm. Gjithashtu, në këtë kontratë midis palëve duhet të jenë shprehur qartë lloji, natyra, qëllimi i përdorimit si dhe të dhënat identifikuese të blerësit (emri, NIPT-i, adresa etj.).

Në rastin kur ndërtesa përdoret për qëllime të veprimtarisë ekonomike nga vetë personi i tatueshëm ndërtues ose nga investitori, në mungesë të kontratës së furnizimit, përveç kontratës së ndërtimit midis ndërtuesit dhe investitorit dhe lejes përkatëse të ndërtimit, personi i tatueshëm që aplikon të drejtën e zgjedhjes, paraqet një deklaratë noteriale për qëllimin e përdorimit të ndërtesës.

3. Në rast se personi i tatueshëm ia furnizon (shet) ndërtesën personave të tatueshëm, të cilët ushtrojnë veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja, furnizimi i ndërtesës trajtohet me TVSH, vetëm në rast se në kontratën e furnizimit, personi i tatueshëm blerës është njohur me këtë fakt dhe ka pranuar të paguajë TVSH-në. Në këtë rast, furnizuesi disponon dhe paraqet edhe kontratën përkatëse. Mungesa e kontratës nuk i jep të drejtën e trajtimit të furnizimit si të tatueshëm.

4. Në ndërtesat ose grupet e ndërtesave, ku përfshihen ndërtesa (ambiente) për të cilat furnizuesi zgjedh opsionin për t'i trajtuar si të tatueshme, por edhe ndërtesa (ambiente) të tjera për banim, e drejta e zgjedhjes nuk shtrihet te ndërtesat për banim, por zbatohet për të gjitha ndërtesat e tjera sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen. Lloji i ndërtesës, natyra e saj dhe qëllimi i përdorimit përcaktohen gjithashtu në lejen e ndërtimit apo miratimet e mëvonshme të marra për zbatimin e lejes. Në rastet kur nuk është e mundur të identifikohet nëse ndërtesa është shitur për qëllime banimi ose jo, atëherë leja e ndërtimit shërben si dokument justifikues dhe vërtetues për të gjykuar mbi aplikimin e opsionit.

5. Zgjedhja nis ditën e parë të muajit në të cilin ajo formalizohet. Pas fillimit të ushtrimit, zgjedhja zbatohet për aq kohë sa nuk ka qenë objekt ndërprerjeje.”.

3.Pas nenit 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:



“Neni 7/1

E drejta e zbritjes kur ushtrohet zgjedhja për furnizimin e ndërtesave

1. E drejta e zbritjes ushtrohet në përputhje me dispozitat dhe përcaktimet në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

2. Në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së, për çdo ndërtesë ose grup ndërtesash që janë përfshirë për t’u trajtuar si të tatueshme ose për çdo ndërtesë ose grup - ndërtesash të cilat i furnizon si të përjashtuara nga TVSH-ja, furnizuesi duhet të evidentojë veçmas zbritjet e TVSH-së për secilën nga ndërtesat ose grup - ndërtesat.

3. Gjithashtu, personi i tatueshëm i cili, përveç veprimtarisë së shitjes së ndërtesave ushtron edhe veprimtari të tjera të tatueshme me TVSH ose jo, në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së duhet të evidentojë veçmas blerjet për secilën kategori të veprimtarisë.

4. Në rastin kur ndërtesa ose grupi i ndërtesave, për të cilën është kërkuar zgjedhja, përfshin ndërtesa (ambiente) për të cilat është ushtruar e drejta e zgjedhjes për t’i trajtuar të tatueshme me TVSH, si dhe ndërtesa (ambiente) për të cilat nuk ushtrohet ose nuk është e lejuar të ushtrohet e drejta e zgjedhjes si ambientet për banim ose ambiente për nevojat e veprimtarisë së blerësve të patatueshëm ose të përjashtuar nga TVSH-ja, të cilët në kontratën e qirasë nuk kanë formuluar shprehimisht të drejtën e zgjedhjes, TVSH-ja zbritet vetëm për tërësinë e ambienteve të përfshira realisht nga e drejta e zgjedhjes së TVSH-së.

5. Nëse furnizuesi i ndërtesës ndodhet në një situatë sipas së cilës e drejta e zgjedhjes, pavarësisht nga vullneti i tij, nuk mund të ushtrohet, ose nëse veprimtaria e tij ndërpritet, ose për shkak të

pushimit të efekteve të zgjedhjes ose heqjes dorë prej saj, apo çdo arsye tjetër, atëherë personi i tatueshëm duhet të procedojë me rregullimin e TVSH-së së zbritur më parë, nëse ndërprerja e transaksioneve të tatueshme ndodh para fillimit të vitit të nëntë pas vitit kur fillon e drejta e zbritjes. Rregullimi i TVSH-së përkon me shumën e TVSH-së të zbritur më parë, e cila zvogëlohet me një të dhjetën për çdo vit, pas datës në të cilën ka përfunduar ndërtesa.

6. Në rastin kur zgjedhja përfundon ose periudha për të cilën ushtrohet zgjedhja është më e shkurtër se afati për të cilin ushtrohet e drejta e zbritjes së TVSH-së për pasurinë e paluajtshme, përfundimi i zgjedhjes sjell për pasojë detyrimin për rregullimin e TVSH-së së zbritur fillimisht nga personi i tatueshëm.”.

4. Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2, referenca “... sipas shkronjës “e”...” zëvendësohet me “...sipas shkronjës “d”...”.

b) Në fjalinë e parë të nënpikës 4.4, referenca “... në shkronjën “d” ...” zëvendësohet me “... në shkronjën “ç” ...”.

c) Në fjalinë e parë, të nënpikës 4.5, referenca “... në shkronjën “e” ...” zëvendësohet me: “... në shkronjën “d” ...”.

ç) Në paragrafin e dytë të nënpikës 4.5, shkronja “a”, fjala “asnjë” zëvendësohet me “një”.

5. Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ANEKSI 1.1.

Përrjashtimi nga TVSH-ja në import për kodet e listuara në aneksin 1.1 jepet vetëm në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë, të kryera në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 8, të këtij vendimi.”

85255000	---- Aparatet e transmetimit
85291069	---- Të tjera
85291039	---- Të tjera
85439000	---- Pjesët
85437090	---- Të tjera
85285920	---- Monokrom
85285931	---- Me ekran të lëngshëm kristal (Teknologjia LCD)
85258019	---- Të tjera
85258099	---- Të tjera
85299092	---- Për kamerat televizive të nënkreut 8525 80 11 dhe 8525 80 19 dhe aparaturat e kreut 8527 dhe 8528
90021100	---- Për kamera, projektorë, ose zmadhues apo zvogëlues fotografikë
90069100	---- Për kamerat
85181095	---- Të tjera
85183095	---- Të tjera
84714900	---- Të tjera, të paraqitura në formë të sistemeve
84715000	---- Njësitë e procesimit ndryshe nga ato të nënkrerëve 8471 41 apo 8471 49, nëse përmbajnë apo jo në të njëjtën karkasë një apo dy prej tipave të mëposhtme të njësisve : njësitë e ruajtjes, njësitë e hyrjes, njësitë e daljes
85176200	---- Makinat për marrjen, shndërrimin dhe transmetimin ose përsëritjen e zërit, imazhit ose të dhënave të tjera, përfshi aparatet e komutacionit dhe <i>routing</i>
85312020	---- Që kanë të trupëzuar dioda drite emetuese (LED)
85312040	---- Që kanë të trupëzuar pajisje matrica aktive me kristal të lëngët (LCD)
94054010	---- Prozhektorët dhe ndriçuesit prozhektor
94054031	---- Të një lloji të përdorur me llambat inkandeshente
94054035	---- Të një lloji të përdorur me llambat fluoreshente në formë tubi
94054039	---- Të tjera
94054099	---- Të tjera
85423190	---- Të tjera
85238099	---- Të tjera
85044088	---- Që kanë një kapacitet të mbajtjes së energjisë më tepër se 7,5 kVA
84158300	---- E papërfshirë me një njësi ftohjeje
84159000	---- Pjesët
847989	---- Të tjera:
84144010	---- Që japin një rrjedhje për minute jo më tepër se 2 cm ³
84212100	---- Për filtrimin ose pastrimin e ujit
84137075	---- Shumëstadësh
84137059	---- Të tjera
84041000	---- Impiantet ndihmës për tu përdorur me kaldajat e kreut 8402 apo 8403
84158200	---- Të tjera, e përfshirë me një njësi ftohjeje
84158100	---- Të trupëzuar me një njësi ftohjeje dhe një valvol për alternimin e ciklit të ftohje/ngrohjes

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë